

**Between Two Worlds in Two Eras:
Representations of Albanians in the Travel Narratives of
Foreign Authors**

Abstract: *This study examines the representations of Albanians in the works of two travel writers from distinct historical periods and cultural contexts: Evliya Çelebi, a 17th-century Ottoman traveller, and Fanny Janet Sandison Blunt, a 19th-century British writer and traveller. The primary objective of this paper is to investigate how these two authors construct and depict Albanian identity, social structures, and cultural practices, while highlighting the similarities and differences that emerge as a result of their respective historical, cultural, and geographical frameworks. Çelebi's narrative, shaped by Ottoman intellectual traditions and the Balkan context of his time, offers an internal portrayal of Albanian society. In contrast, Blunt's account, influenced by Victorian-era Western sensibilities and orientalist perspectives, reflects a more external and interpretive gaze.*

The central research question addresses the way the Albanians were perceived by each author, and to what extent such perceptions converge or diverge. Through a close, comparative analysis of these travel accounts, the paper contributes to a broader understanding of how external narratives have shaped and influenced the construction of national and social imaginaries of the Albanian people. Moreover, by drawing on two culturally and temporally distinct viewpoints, the study emphasizes the complexity of foreign representations of Albanians and considers the role of historical and cultural narratives in both reinforcing stereotypes and shaping cultural identities.

Keywords: *Albanians, Travelogue, Evliya Çelebi, Lady Blunt, Cultural Identity.*

1. Hyrje

Ky punim synon të vendosë në një dialog krahasimtar veprat e dy autorëve udhëtarë të shquar: Evliya Çelebi dhe Lady Blunt, të cilët, ndonëse i ndajnë dy shekuj dhe dy horizonte kulturore të ndryshme, Perandoria Osmane e shekullit XVII dhe bota britanike e shekullit XIX, ndajnë një pikë takimi të

veçantë: përshkrimin e shqiptarëve dhe të hapësirës shqiptare si subjekt i vëzhgimit të tyre. Interesimi i tyre për këtë realitet gjeografik, shoqëror dhe kulturor nuk është vetëm rastësor, por i lidhur me mënyrën se si “tjetri” perceptohet dhe konstruktohet në një kontekst udhëtimi, nëpërmjet përvojës personale, vëzhgimit antropologjik dhe formës narrative.

Duhet bërë të ditur se këta dy autorë i kam trajtuar veçmas në dy punime të mëhershme, ku secili autor është analizuar si një rast i veçantë i ndërtimit të përfytyrimeve për shqiptarët në raport me kohën, kulturën dhe përkatësinë e vet.¹ Por, në këtë punim, qasja e tejkalon analizën individuale në një përpjekje për t’i vënë këta dy autorë në dialog krahasimtar, duke eksploruar jo vetëm kontrastet në përfaqësimet që ofrojnë, por edhe mënyrën se si objektivi i përbashkët, pra shqiptari si figurë kulturore dhe politike, bëhet vendtakim i perceptimeve të ndryshme. Në këtë mënyrë, studimi jo vetëm ndriçon narrativat që kanë ndikuar në mënyrën se si shqiptarët janë përfaqësuar në letërsinë udhëpërshkrimore (*traveling literature*) ose *travelog*² të shekujve të ndryshëm, por edhe hap rrugë për një lexim më të thellë të ndërlidhjeve ndërkulturore në hartën e përfytyrimeve për tjetrin ballkanik.

Në librin e tij “*Inventing Eastern Europe*”, Larry Wolff thotë se Evropa Lindore para shekullit të XVIII nuk ishte e përkufizuar siç është sot, pasi që ajo atëherë ishte ende duke marrë formë në mendjet dhe veprat e udhëtarëve të parë që filluan ta eksplorojnë këtë pjesë të saj. Nuk ishte as Azi as Orient, por një hapësirë gjeografike e ndërmjetme, pa një lokacion të saktë në kohë ose në histori.³ Vizitorët e parë që erdhën nga Evropa qendrore qenë të befasuar me mënyrën e jetesës, me dukjen e sjelljen e banorëve, me kostumet, por edhe me dallimet racore, duke e cilësuar Evropën Lindore një grumbull të çuditshëm të njerëzve primitivë.⁴ U konsideruan të këtillë banorët e vendeve më pak të zhvilluara, por edhe të panjohura, siç ishte Ballkani për pjesën tjetër të Evropës së zhvilluar. Nga shkrimet dhe librat e autorëve perëndimorë, të shumë misionarëve e udhëpërshkruesve të

1 Shënim: Për më shumë detaje mbi folklorit shqiptar në librat e Evliya Çelebi-ut shih punimin tim “Të dhëna për folklorin shqiptar në udhëpërshkrimet e Evlija Çelebiut”, i botuar në vëllimin “*Albanologji*” II-14/2015 (botues: Instituti Albanologjik, Prishtinë), ku publikohen punimet nga konferenca e Javës së Albanologjisë. Përderisa për këndvështrimet e Lady Blunt, shih punimin tim “Shqiptarët në veprat dhe kujtimet e Lady Blunt”, revista shkencore “*Gjurmime Albanologjike*” 49/2019. Instituti Albanologjik, Prishtinë.

2 Shënim: Travelog – zhanër i veçantë në letërsi i shkruar në veten e parë, ku autori, me stil përshkrues dhe emocional, vëzhgimin kulturor dhe ndërkulturor e përshkruan duke bërë kombinim të informacionit faktik me ndjesinë subjektive.

3 L. WOLFF, *Inventing Eastern Europe: The Map of Civilization on the map of the Enlightenment*, Stanford University Press, California 1994, 17-49 /19.

4 *Ibid.*, 38.

huaj që e vizituan Ballkanit, apo edhe që qëndruan për një kohë në këto vise, u krijuan stereotipet, të cilat ende vazhdojnë ta shoqërojnë figurën e ballkanasit, me të gjitha tiparet e tij kulturore, shpirtërore e materiale, si një evropian tjetër më pak i qytetëruar, mu edhe për faktin e një afërsie me kulturën aziatike, të cilës gjeografikisht Ballkani nuk i qëndron shumë larg. Por, konotacione të ngjashme hasim edhe tek librat e udhëpërshkruesve që erdhën nga Lindja, prej të cilëve Ballkani gjithashtu u këndvështua si një zonë kulturalisht e ndryshme edhe nga Orienti, pothuajse aq dallueshëm sa edhe nga kultura oksidentale. Si një zonë e ndërmjetme midis Lindjes dhe Perëndimit, asnjëherë e identifikuar mjaftueshëm me tiparet tipike të njërës apo tjetrës botë kulturore, Ballkani i kishte tiparet e të dyjave, sepse këtu u ndeshën historikisht të dy civilizimet, si dominime forcash ashtu edhe kulturash, në të gjitha dimensionet e tyre.

Veprat e autorëve nga Lindja dhe nga Perëndimi të cilët i provokoi Ballkani, u trajtuan më pas nga autorët ballkanikë dhe më gjerë, të cilët raportin autor të huaj/vendas nga Ballkani e trajtuan në aspektin kritik, më në thellësi e më në detaje, duke u bërë që kjo “tjetërsi” të bëhet edhe preokupim i shkencave si antropologjia, letërsia, filozofia e sociologjia e deri tek historia, çka ka rezultuar së fundmi me disiplinën e imagologjisë, apo të përfytyrimeve letrare rreth tjetrit.⁵ Sipas Maria Todorovës, si një nëngjini e kësaj discipline konsiderohet edhe diskutimi për orientalizimin, që është çështje e pashmangshme kur flasim për Tjetrin lindor e ballkanik. Por, ajo, në librin e saj, e kundërshton këtë tezë, duke sjellë argumente për shumësi identitetesh etnike në këtë pjesë të Evropës, identitete të cilat nuk mund të trajtohen vetëm nën kupolën e orientalizmit. Të këtij orientizmi, të cilin Eduard Said, në studimin e tij për imagjinimin evropian të Orientit, kur e redukton në formën më të thjeshtë, e jep si më poshtë:

“Perëndimi dhe Orienti dallohen sipas raportit dominues/ të dominuar që nënkupton pushtimin e tokave të të dytëve nga të parët, duke pasur një kontroll të ashpër mbi punët e tyre të brendshme, përderisa gjaku dhe pasuria e tyre të vihen në dispozicion të njerës apo tjetrës fuqi perëndimore.”⁶

Padyshim që kjo është një formë e vrazhdë e gjykimit evropian ndaj orientalizmit, por që bazën e ka në Evropën Perëndimore dhe në qëndrimin e saj kundrejt kulturave të tjera, kundrejt të tjerëve jo-perëndimorë, respektivisht të konsideruar më pak evropianë. Ky dallim është i theksuar edhe më shumë në Ballkan, në këtë pjesë të Evropës Jugperëndimore ku

5 M. TODOROVA, *Ballkani imagjinar*, (përkth. B. Shehu), Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit], Tiranë, 2006, 19.

6 E. SAID, *Orientalizmi: Imagjinimi evropian i Orientit*, (përkth. N. Seitaj), 2 Lindje dhe 2 Perëndime, Tiranë, 2009, 68.

u ndeshën perandoritë e ku shumë herë u përballën ushtritë e fuqive të mëdha botërore, e ku historia ka njohur periudha armiqësish e luftërash, të cilat i kanë përplasur kulturat e ndryshme. Përplasjet e këtilla e kanë theksuar edhe më shumë dallimin ndërmjet vendasve e pushtuesve, lindorëve e perëndimorëve, të të kulturuarve evropianë e të pakulturuarve ballkanas, Perëndimit superior e Orientit inferior e shumë kategorive të tjera përjashtuese, të cilat, ndoshta, këtu më shumë se askund tjetër, e prodhojnë dihotominë ‘vetja dhe tjetri’ – dy kategori dalluese kulturore, siç shkruan edhe antropologu sloven:

“Për qindravjeçarë të tërë evropianët e kanë bërë një diferencim midis pjesëtarëve të ‘shoqërisë së civilizuar’ në njërën anë dhe ‘primitivëve’, ‘barbarëve’ dhe ‘të egërve’ në anën tjetër, me qëllim për të cilësuar veten e tyre si popuj të civilizuar. Për këtë atyre u duhej e kundërta e tyre, e tyrja Tjetër, dhe popujt e Ballkanit i shërbenin këtij qëllimi në mënyrë perfekte. Në fakt është shumë e vështirë të imagjinosh një Tjetër të përcaktuar në mënyrë më precize sesa popujt e Ballkanit.”⁷

Këtë tezë të Jezernik-ut e gjejmë edhe tek autorë të tjerë, në kontekste analizash të tjera, por që shpjegimi buron nga i njëjti dallim kulturor – ballkanasi tjetër ose evropiani i paqytetëruar. Është edhe pjesa e kulturës gjermanike të Evropës, e cila përfaqëson një dominim kulturor të një periudhe tjetër perandorake, për të cilët Ballkani është një Evropë tjetër, siç shkruan antropologu Albert Doja, në një kontekst më të ngushtë, kur analizon parakushtet që ndikuan në krijimin e Ballkanologjisë (nëndegë e së cilës më vonë rezultoi të jetë Albanologjia), nga perspektiva e shkrimeve gjermanike, si një shkencë për tjetrin:

“Si *Völkerkunde* edhe *Volkskunde* dolën nga tradita historiciste e muzeumeve në të cilën *Völkerkunde* kishte të bënte me historinë kulturore të të tjerëve të jashtëm ndërsa *Volkskunde* me të tjerët historikë të traditës kulturore kombëtare. Më shumë se thjesht një vijë ndarëse ndërmjet tyre, nënkuptohet një ndarje plotësuese e punës midis tyre, dhe të dyjat kanë kontribuar në konstruktimin e “Tjetrit” brenda dhe jashtë Europës.”⁸

Apo, siç thotë edhe Todorova, se Ballkani përfaqësonte Evropën e vjetër, të kaluarën e saj, formën e pazhvilluar të saj nga e cila ajo dëshironte të shkëputej dhe të mos identifikohet më, prandaj krahas imazhit negativ i është vënë edhe ‘damka’ e orientalizmit. Por, sipas së njëjtës autore,

7 B. JEZERNIK, *Evropa e egër*, (përkth. D. Varfi), Plejad, Tiranë, 2010, 28.

8 A. DOJA, *Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2018, 121-149.

orientalizmi i Ballkanit nuk është aziatik, por është ura lidhëse ndërmjet lindjes dhe perëndimit, ndërmjet Orientit e Perëndimit, të cilën në vend se si njollë duhet ta shohim si vlerë.⁹

Një qëndrim të këtillë para Todorovës e kishte shprehur Larry Wolff në monografinë tij mbi zbulimin e Evropës Lindore, i cili nëpërmjet shembujve nga historia sjell edhe të dhëna që e dëshmojnë atë, siç është rasti me Herder-i, i cili pas vizitës që ia bëri Rigës (1769) në Letoni dhe më pas vendeve të tjera baltike e sllave në Evropën Lindore, me të parë dhe vlerësuar veçantitë kulturore e kombëtare të secilit popull, ndërtoi tezën e tij mbi rëndësinë e folklorit për konsolidimin e identitetit nacional.¹⁰

Kureshtja dhe interesimi i Tjetrit evropiano-perëndimor për Tjetrin ballkanik dhe kulturën e tij ekzotike ka qenë gjithmonë e lartë, siç e konfirmojnë edhe autorët britanikë John Allcock dhe Antonia Young, “Sido që të jenë, ose pretendojnë të jenë, ata gjithmonë mbesin të paplotë, të marginalizuar, të paqartë, të ndryshëm gjithsesi. Këtu mbase qëndron një rrënjë tjetër e magjepsjes së shumë prej nesh me Ballkanin.”¹¹

Me një fokus në këndvështrimet e tyre për shqiptarët, por duke ofruar dy pozicione të ndryshme në kohë dhe në hapësirë, kam zgjedhur të shoh si i panë shqiptarët dy autorë, respektivisht udhëpërshkrues që qëndruan në këto anë për një kohë të caktuar: Evliya Çelebi, udhëtari osman i shekullit të XVII-të dhe Fanny Janet Sandison Blunt, shkrimtarja dhe udhëtarja britanike e shekullit të XIX-të.

2. Evliya Çelebi, kronikani pasionant që shkroi për shqiptarët në shek. XVII

Sipas Robert Dankoff, i cili u mor me krijimtarinë e tij të lënë trashëgim, Evliya Çelebi-u, ishte një udhëtar i pasionuar otoman, që kishte bërë shumë vizita nëpër viset ku shtrihej pushteti i Perandorisë osmane. Ai duke qenë biri i një oborrtari të pasur, pasionin e udhëtimit e kishte zhvilluar që në fëmijëri, duke i dëgjuar rrëfimet e shokëve të të atit për vendet e ndryshme të botës, sikur edhe nga një ëndërr rinore ku thoshte se vetë profeti Muhamet e kishte bekuar Çelebi-un për të bërë udhëtime. I njohur për zgjuarësi, për aftësinë e të mësuarit si edhe për zërin e bukur (e recitonte Kur’anin për 8 orë), ai në fillim lehtësisht ishte bërë pjesë e shpurës së pashallarëve gjatë ekspeditave në zona të ndryshme të perandorisë. Më pas detyrat e tij prej sekretari, imami, muezini, lajmëtari, ndërlidhësi, por edhe shoqëruesi e tregimtari, i kishin dhënë mundësi të mëdha që të realizojë pasionin e tij për

9 M. TODOROVA, *Ballkani imagjinar*, 32.

10 L. WOLFF, *Inventing Eastern Europe*, 312.

11 J. B. ALLCOCK – A. YOUNG (eds.), *Black Lambs and Grey Falcons – Women Travellers in the Balkans*, Bradford University Press, UK, 1991, xvii.

udhëtimet, si edhe më pas të shkruajë librin dhjetëvëllimësh *Seyahatnamesi* (Libri i udhëtimeve). Ky libër është një panoramë e gjerë përshkruese për viset e Perandorisë osmane dhe të rrethinave të saj, në një periudhë dyzet vjeçare (1640-80).¹² Robert Elsie bashkë me Robert Dandroff e përgatitën për botim një pjesë të librit të udhëpërshkruesit Evliya Çelebi në gjuhën angleze¹³ dhe më pas bashkë me Abdurrahim Myftiun e përkthyen dhe e përgatitën për botim në shqip, i cili titullohet “Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Ohër”.¹⁴

Duke iu referuar parathënies së këtij libri kuptojmë që Evlija Çelebi-u, realizoi një udhëtim në Kosovë (1660), në Shqipërinë veriore dhe në Mal të Zi (1662) dhe në Shqipërinë jugore (1670) dhe shënimet për këto vise gjenden në vëllimet V-VIII. Libri përbëhet nga tre kapitujt kryesorë që ndahen sipas vendeve që vizitoi: I. Nëpër Kosovë; II. Nëpër Shqipërinë e Veriut dhe Malin e Zi, si edhe III. Nëpër Shqipërinë jugore; për të vazhduar me pjesën e katërt që është Fjalorthi i përpiluar nga Çelebiu për nevojat praktike të komunikimit të tij me vendasit.

Duke e përshkuar librin e Çelebiut, që e sjell Elsi, pasurohemi me informacione të shumta për natyrën e vendeve që i viziton, për popullsinë, organizimin e jetës nëpër qytete, arkitekturën, origjinën dhe gjuhën e popujve që i ka dëgjuar personalisht, në këtë rast shqiptarët dhe shqipen. Ai jep shumë të dhëna lidhur me organizimin administrativ otoman të qyteteve, siç edhe jep shumë përshkrime sipas përshtypjeve dhe pikëpamjeve personale. Të detajuara janë edhe të dhënat për besimet fetare, për përhapjen e islamizimit, si edhe për vendet e shenjta. Këtu do të përpiqemi të mos bëjmë vetëm bartjen e tyre si “lëndë të parë”, por do të provojmë ta shohim këtë material nga një prizëm tjetër. Do të përpiqemi t’i shohim shqiptarët, botën dhe tyre dhe veçantitë e jetës së tyre para katërqind vitesh, sipas syrit të Evlija Çelebiut. Çka vërejtje Çelebiu të veçantë tek shqiptarët?

2.1. Tradita dhe folklori të ndërthurura në informacionet historike, gjeografike e teologjike

Sipas Gotfrid Hagen, i cili e bëri pasthënien e librit “Një mentalitet otoman, bota e Evlija Çelebiut”, mentalitetin otoman, të shprehur sipas botës së Çelebiut, ai e sheh të organizuar sipas njohjes që buron nga përvoja e shprehur në këto dimensione: përvoja e hapësirës, pra të shikuarit përreth, e cila manifestohet në këto drejtime horizontale që janë: *të përshkruarit*

12 R. DANKOFF, *An Ottoman Mentality-The World of Evliya Çelebi*, Brill, Leiden –Boston, 2006, 2.

13 R. ELSIE – R. DANKOFF, *Evliya Çelebi in Albania and Adjacent Regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*, Brill, Leiden-Boston, 2000.

14 R. ELSIE, *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Ohër*, (përkth. A. Myftiu), Shtëpia Botuese 55, Tirana 2008.

dhe *gjeografia*; përvoja e kohës, pra të shikuarit prapa, dhe me këtë nënkuptohet *historia*; dhe dimension i katërt, që është vertikal, i cili mund të merret si metaforë për marrëdhënien midis njeriut dhe Zotit, me çka nënkuptohet *teologjia*.¹⁵ Brenda këtyre dimensioneve do të shkoqisim të dhënat për traditën e folklorin shqiptar, të dhënat nga mitologjia, festat e motmotit, vajtimet, nga traditat e dasmës, e mikpritjes, veshjet popullore, kultura e ushqimit, e mjekësisë popullore, nga arkitektura popullore, zejjet, zanatet etj. Shumë herë të ndërthurura apo “të fshehura” brenda të dhënave gjeografike, historike e teologjike, ato mbeten materiale shumë të vlershme për të njohur shqiptarët dhe jetën e tyre në atë kohë.

I ndërlidhur me interesimet tona, është rrëfimi për ngjarjen e Betejës së Kosovës të vitit 1389, të cilin Evlija Çelebiu, e paraqet që në hyrje të përshkrimit të tij për vizitën në Kosovë më 1620. Në fakt, ndonëse i referohet shkurt ngjarjes së vrasjes së Sulltan Muratit të I-rë, (apo Gazi Hudavendingarit, siç i thotë ai) nga Millosh Kopiliqi (“një i pafe ogurzi me emrin Koblaki”) ku sipas legjendës thuhet se “duke u hequr si lajmëtar, (Kopiliqi) iu afrua Sulltanit për t’i puthur dorën, por pastaj e nxori kamën dhe e vrau”¹⁶ e veçanta që sjell Çelebiu, është e dhëna për një traditë që lindi në pushtetin osman, e që u kodifikua sipas ligjit të asaj kohe, menjëherë pas kësaj ngjarjeje:

“Që prej asaj kohe, sa herë që ndonjë lajmëtar i vete afër ndonjërit nga dinastia osmane, Sulltani rri ulur në frond dhe lajmëtari puth një mëngë të gjatë qepur rrobës mbretërore, duke u ruajtur mirë në të dyja anët. Në fillim lajmëtari duhet të puthë tokën e më pas mëngën, e cila është tetë pash e gjatë dhe nuk i lejohet t’i afrohet më shumë. Ky ka qenë zakoni sipas ligjit osman qysh nga koha kur Gazi Hudavedingari u vra”.¹⁷

Krahas të dhënës se “Gjatë betejës së Fushë Kosovës sulltan Muradi shkoi 700 000 të pafe në teh të shpatës”¹⁸ një masakër në emër të pushtimit dhe përhapjes së detyrueshme të fesë islame, kronikani Çelebi i cili vjen nga një kulturë e njejtë me të prijësit të tij, nuk i zbehë as i mbulon cilësitë dhe mizoritë e një pushtuesi. Ai gjithashtu e tregon si të qenë edhe aktin e vrasjes së vetë sulltanit, ndonëse në një kohë prej 230 viteve më pas, pra edhe sot, vazhdon të jetë i mbuluar me mistere rreth vërtetësisë së atij akti.¹⁹ Intriguese është edhe e dhëna për traditën e mbikrijuar në kulturën

15 G. HAGEN, *Ottoman Understandings of the World in the Seventeenth Century*, në *An Ottoman Mentality-The World of Evliya Çelebi*, Brill, Leiden-Boston, 2006, 215.

16 R. ELSIE, *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje*, 11.

17 *Ibid.*, 12.

18 *Ibid.*, 1.

19 A. D. LELLIO, *The Battle of Kosovo 1389: An Albanian Epic*, I.B. Tauris: London, 2009.

e sulltanateve otomane për kujdesin e përsëritjes me të huajt, traditë kjo që u krijua nga momenti i vrasjes së tij nga një “i pafe” siç ishte Millosh Kopiliqi.

Informacione të këtilla, nga sfondi historik, që nxjerrin të dhëna edhe për folklorin, i gjejmë të shumta në këtë libër të Çelebi-ut, duke iu referuar çështjeve së origjinës së qyteteve e fortifikatave që ai i vizitoi, historisë e legjendave për figura të ndryshme, apo edhe origjinës etnike të shqiptarëve. Të dhënave të këtilla nuk mundemi gjithmonë t’i referohemi si të dhëna historike, pasi që deri më tani historia nuk i ka vërtetuar, dhe koha i ka demantuar, por megjithatë kur e kemi parasysh faktin se ato janë shënuar mbi katërqind vite para kohës që jetojmë, kur informacionet dhe dëshmitë e kishin shumë të lehtë të ndryshoheshin e të humbeshin, vlera e tyre mbetet e arsyetuar vetëm me vulën e kohës.

I referohemi këtu një legjende, e cila sipas Çelebiut, flet për origjinën e shqiptarëve. Sipas saj, shqiptarët e kanë origjinën nga fisi arab i Kurejshëve dhe katragjyshi i tyre është Xhabal-i Elhema, shok i profetit të shenjtë, tyrbja e të cilit ishte vend i shenjtë afër Elbasanit, të cilën sot e vizitojnë shumë stërnipërit e tij, arnautët e sotëm. Xhabal-i Elhema që kishte qenë një trim i pashoq arab, gjatë luftimeve ia kishte nxjerrë njërin sy një sheikut arab, i cili më pas kishte kërkuar nga profeti që t’a lejojë ta zëvendësojë me njërin sy të Xhabalit. Ky i fundit duke mos pranuar kishte thënë “Mos qoftë turp” (Ar-na-bud) dhe me shumë pjesëtarë të fisit të tij ishte shpërngulur në tokat e atëhershme spanjolle, që kishin qenë krahinat shqiptare të Delvinës e Vlorës. Në fillim ishin vendosur në malin e Kurjeleshit (Kurvelesh) dhe sot vazhdojnë të jetojnë breza të tërë me mburrje se kanë prejardhje nga fisi arab i Kurejshit, por të cilët duke u përzier me frankët e pabesë, e mohuan fenë muslimane të Xhabal-i Elhemës dhe sot janë të pafe, por vazhdojnë të jenë trima luftëtarë e burra të zgjuar sikur paraardhësi i tyre.²⁰ Një teze e këtillë është cilësuar si teori falsifikimi për origjinën e shqiptarëve nga historiani Miokom Zeqo.²¹

Të dhënat geografike, peshojnë më së shumti në këtë libër, ndoshta edhe më shumë për faktin se autori e kishte për qëllim, por edhe aftësi, që të përshkruante atë që shihte. Kështu përshkrimi i hapësirës, bashkë edhe me përshkrimet e lëvizjeve të tij nga njëra kala në tjetrën, të cilat gjithmonë shoqëroheshin me mikpritjen që ja ofronin tërë shpurës së shërbyesit të Sulltanit administratorët otomanë të vendosur në këto qytetete, i jep karakter kronologjik këtij libri. Lëvizjet e tij, të shoqëruara në detaje me përshkrimet shumë personale, herë herë të japin edhe ndjesinë e leximit të ditarit të Çelebi-ut. Në këto përshkrime, të cilat edhe paraqesin përballjen,

20 R. ELSIE, *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje*, 48-51; 123-125

21 M. ZEZO, Teori falsifikimi për origjinën e shqiptarëve, *Gazeta Dielli*, <https://gazetadielli.com/teori-falsifikimi-per-origjinen-e-shqiptareve/> [shikuar më: 13. VI. 2025].

respektivisht kontaktin e Çelebi-ut me botën “arnaute”, ne arrijmë të kuptojmë përshtypjet e tij në raport me këtë botë, të re dhe të ndryshme, nga ajo e tij. Informacione më të zgjeruara dhe më të hollësishme jepen për qytetet e mëdha si Shkodra, Gjirokastra, Vlora, Elbasani, më pak për ato më të vogla si Prishtina, Vushtria, Gjakova, Delvina, Struga, Durrësi etj. çka nënkuptohet edhe për statusin e këtyre qyteteve (kalave) në atë kohë. Të dhënat që dalin nga këto skema të njehta për qytetet, ofrojnë edhe të dhëna që ndonjëherë mbesin në kategorinë e statistikave, dhe këtu nuk do të ndaleshim, sepse më tepër janë me interes për hulumtues të fushave të tjera, siç edhe janë shumë me interes për anualet e kronikat e qyteteve. Si shembull e shkoqisim një shkrim të shkurtër, por mjaft informues për Gjakovën në shekullin XVII:

“Duke vijuar udhën, prej këndeje mbërritëm në qytetin e Gjakovës. Një Gjakovë tjetër është gjetiu në sanxhakun e Pozhegut, por kjo Gjakovë gjendet në sanxhakun e Dukagjinit. Është qytet i begatë dhe tërheqës, me 2000 shtëpi, të gjitha prej guri me çati e kopshtije. Qeveriset nga një vojvodë dhe ka një kadi me nivel page 150 akçesh. Godinat publike gjenden në një shesh të gjerë. Ndër to janë dy xhami të mëdha, goxha të zbukuruara; disa faltore; disa hane me çati plumbi, të cilat në këtë kohë janë kthyer në depo galetash ushtrie e municionesh për fushatën e Kotorrit; si dhe 300 dyqane, si fole bilbilash. Falë klimës së butë, djemuria janë shumë të hijshëm.”²²

Të dhëna si këto, të dokumentuara para katër shekujsh, sot flasim më shumë se vetëm dëshmi historike. Edhe pse në nivel informativ ato e japin një pasqyrë të përgjithshme kulturore, sociale, urbane për vendin që përshkruhet. Një personalitet i pazakontë, një gjentëllmen i kulturuar osman, i devotshëm por edhe jokonvencional, i vëmendshëm dhe kureshtar, kurioz për gjithçka, i pasionuar për udhëtimet dhe i përcaktuar për të lënë të dokumentuar e të kompletuar veprën e tij mbi udhëtimet, siç shprehet Robert Dankoff²³ bëri që shumë vende, përfshirë edhe neve, të arrijnë të kenë sot kronikat e tyre urbane që nga shekulli i XVII-të.

2.2. Tiparet etnografike si pjesë e pashmangshme e udhëpërshkrimeve

Veçoritë specifike të shqiptarëve, respektivisht shume tradita te evidentuara nga Çelebi-u në atë kohë, na ndihmojnë të kuptojmë më shumë për trashëgiminë tonë, respektivisht të jemi në dijeni për vazhdimësinë,

22 R. ELSIE, *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje*, 41.

23 R. DANKOFF – S. KIM, (eds.), *An Ottoman Traveler*, Eland, London, 2011, X.

ruajtjen por edhe shuarjen e tyre. Shënimet e tij e zgjojnë kureshtjen tonë, për të parë si jemi dukur ne në sytë e një otomani në atë kohë. Ai na sjell pamje të veçantive tona etnike, duke i përshkruar shumë zakone e tradita, të cilat na dallojnë, madje shpesh na “përrjashtojnë” edhe nga devotshmëria ndaj fesë muslimane:

“Një tjetër zakon i çuditshëm. Gjirokastritët kujtojnë me vaje të afërmit e vdekur para dyzet a pesëdhjetë vjet, qëllon edhe tetëdhjetë vjet. Çdo ditë të diell, të gjithë të afërmit e të vdekurit mbledhen në një shtëpi të rrënuar, paguajnë vajtojca profesioniste, që qajnë e venë kujën e që çirren e vajtojnë, sa lebetia e tyre dëgjohet deri në fund të botës. Për shkak të kësaj zhurme e potereje, të dielave nuk rrihet në qytet. Kjo është arsyeja që Gjirokastrës i kam vënë nofkën “qytet i vajtimeve”. Është tepër e habitshme se si vajtojcet profesioniste ia dalin të vënë kujën e të qajnë me aq shpirt, më fort se për të afërmit e tyre, për dikë, që ka njëqind vjet vdekur dhe me të cilin nuk kanë kurrfarë lidhje gjaku. Dhe si vajtojnë, pa! (...) Sigurisht është punë fisnike; por zija për dikë që ka vdekur para njëqind vjetësh mua më duket krejt pa kuptim. Megjithatë, fshat e zanat, shtëpi e tabijat”.²⁴

Siç shihet nga ky paragraph i shkëputur, krahas paraqitjes së tipareve tradicionale popullore, apo “zakoneve të çuditshme” që i kanë bërë përshtypje Çelebi-ut në Gjirokastër, sot arrijmë të kuptojmë për ritualin e vajtimeve, vajtojcet dhe mënyrën si janë motivuar ato për të vajtuar, këtu e katër shekuj më parë. E dhënë kjo që e dokumenton praninë e këtij riti në kulturën tonë bashkë me lashtësinë e tij e madje edhe njohjen e tij deri në ditët tona.

Të së njejtës natyre shprehëse, kuptojmë edhe të dhëna të tjera për: dasmat, mënyra si bëheshin dasmat; festat e motmotit që festoheshin në atë kohë, përfshirë ato islame e të krishtera, sikur edhe devijimin nga përkushtimi ndaj religjionit, të cilin Çelebi-u e cilëson: “Një tjetër zakon i keq i gjirokastritëve. Në raste dasmash, në ditë kremtesh si ato të Shën Gjergjit, Nevruzit, Shën Mitrit dhe Shën Kollit, si edhe dy festat e Bajramit, ata vishen me rrobat më të mira dhe pijnë pije alkoolike të ndryshme.”²⁵

Krahas linjës së informatave për aktivitetet shoqërore e argëtuese, kuptojmë shumë të dhëna për veshjet, për mënyrën si vishehsin shqiptarët, të cilat Çelebi-u i jep në detaje, për çdo qytet, në veçanti për secilin grup moshe e gjinie, si p.sh. të dhënat e mëposhtme për veshjet e grave të Shkodrës:

24 R. ELSIE, *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje*, 60.

25 *Ibid.*, 62.

“Veshjet e grave kokulura. Ato të gjitha mbajnë ferexhe cohe deri në fund të këmbës dhe mbulesë kreje interesante në trajtë konike, si qylafët e rojeve perandorake dhe mbështillen me një shall tyli të bardhë. Në këmbë mbathin shapka apo këpucë të buta e të verdha shtëpie. Kanë të ecur të hijshme.”²⁶

Nëse vazhdojmë me skemën e Hagen-it, dimensionimi i fundit i të dhënave që sjell Çelebiu, është dimensionimi teologjik. Në këtë rrafsh, në libër, e sigurisht në tërë *Sejihatnamenë*, vëmendja e udhëpërshkruesit është në mbledhjen dhe evidentimin e gjendjes së besimeve të popujve që i vizitonte. Pra udhëtimi i tij, në pjesën më të madhe të përshkrimeve, fokusohet në objektet e kultit, në formën dhe mënyrën që besimtarët e shprehin besimin e tyre, në përkushtimin ose jo të tyre ndaj fesë, në përluljen ndaj figurave fetare, si dhe të dhënat për vetë figurat fetare. Sipas Dankof, vetë Evliai i bashkohej shumë herë sufizmit, por a ishte ai sufi i vërtetë? Gjatë shumë udhëtimeve të tij ai falej në teqetë e dervishëve Bektashi, por kishte përkushtim për teqe të tarikateve të veçanta, sikur ishte tarikati Halveti, edhe pse shihet se është falur dhe lutur edhe në teqe të tarikateve të tjera gjatë vizitave në vende të tjera të Evropës.²⁷ Pra kërkimet e tij në drejtim të informacioneve për besimet i gjejmë shumë të pranishme edhe në librin që kemi në dorë. Në secilin prezantim fillestar për qytetet, ai do të japë shënime për numrin e xhamive, të teqeve dhe të tyrbeve në atë qytet, si edhe për lutjet e mënyrën e faljeve të banorëve të atij qytetit. Ndoshta ngaqë islamizmi ishte ende në fillimet e tij në këto anë në atë kohë, në librin e Çelebiut, vërehet një mungesë përkushtimit të plotë e popullsisë vendase ndaj besimit islam, të cilën ai e paraqet me syrin e kronikanit. Natyrisht nëpërmjet figurat fetare të cilave ata iu falen, e që janë personalitete nga historia e religjioneve, ai identifikon edhe orientimin e besimit të tyre. P.sh.

“Pjesa më e madhe e gjirokastritëve i falen Aliut dhe familjes së Profetit. Ata rrinë ndenjor dhe thërrasin “Ja Ali!” dhe po ashtu ngrihen me këmbë dhe thërrasin “Ja Ali!” Të gjithë dijnë të lexojnë persisht. Sepse ushqejnë dashuri për Aliun e për Profetin, njëri grup nën zë mallkon Mavijen dhe haptazi mallkon Jezidin, të paktën kështu më thanë, se me veshët e mi nuk kam dëgjuar gjë. Këta njerëz janë të dhënë pas qejfeve, pijes e të ngrënave. Nuk e kanë për gjë të pijnë verë dhe pije të tjera dehëse e dalldisëse, sikundër është ajo që i thonë “rejhanije”.²⁸

Gjatë përshkrimeve për përkushtimin ndaj fesë, gjejmë edhe situata të

26 *Ibid.*, 28.

27 DANKOFF, R. DANKOFF, *An Ottoman Mentality-The World of Evliya Çelebi*, 122.

28 R. ELSIE, *Evliya Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje*, 62.

këtilla, sikur kjo për banorët e fshatit Zharovinë, një fshat afër Janinës: “Më pas morëm udhën e kthimit, duke vazhduar festën e madhe gjatë gjithë rrugës me kolonën e krushqve. Të gjithë të rinjtë thërrisnin “Allah, Allah” dhe përsëri hidhnin valle si të krishterët.”²⁹

Nga përshkrimet e detajuara dhe mjaft interesante mbi raportin e shqiptarëve me fenë por edhe me ritet fetare, vërejmë se Çelebi-ut i ishte krijuar konfuzion lidhur me devotshmërinë e tyre ndaj njëres apo tjetres fe, ashtu si edhe ndaj të gjithave njëkohësisht. Toleranca ndaj fesë së tjetrit, respektimi i riteve dhe festave të të tri feve, krahas edhe një lirie ndaj pirjes dhe qejfeve, e shpreh që atëherë kompleksitetin e raportit të shqiptarëve me fetë. Siç shihet toleranca fetare si një tipar identifikues i shqiptarëve edhe sot, ka një histori të vjetër dhe trashëgimi të gjatë mirëkuptimi e pranimi të tjetrit, siç e ka shprehur në mënyrë simbolike Çelebi- “të gjithë thërrisnin Allah dhe hidhnin valle si të krishterët”. Nëpërmjet këtij përshkrimi, i cili mund ta ketë shpjegimin e edhe në vetë Ballkanin si një territor ku u takuan dhe u ndeshën shpesh qytetërimet e kulturat që vinin nga Lindja e nga Perëndimi, shihet se marrëdhënia e shqiptarëve me fenë ishte më shumë kulturore dhe identitare sesa dogmatike. Dhe kjo është evidentuar që para katër shekujve, më së paku.

Një tjetër aspekt i veçantë kulturor ishte tradita e gatimit dhe e gastronomisë, së cilës iu përkushtua Çelebi-u për ta evidentuar. Për pothuajse secilin qytet, ofrohen llojet ushqimeve dhe të gatimeve që konsumohen, duke dëshmuar për shumë receta të kuzhinës orientale si *bakllavaja*, *byreku*, *kajmaku*, *tavatë*, *çyreku*, *kulaçi*, por edhe për autoktone si *simitja e bardhë shqiptare* e *pogaçja e pjekur në prush*. Krahas gatimit, tradita e mikpritjes është e pjesë e pashmangshme përbërëse e saj, e cila është një ndër tiparet e rralla të shqiptarëve, të cilën pa asnjë dyshim do ta vërejë Çelebi-u. E gjejmë për shembull, të përmendur në veprën e tij një të dhënë me interes për mikpritjen në disa qytete, nga ku po e shkoqisim qytetin e Prishtinës: “Paria dhe familjet në gjendje të mirë e kanë për kënaqësi të presin mysafirë të pasur e të varfër qofshin, të rinj e të moshuar, të cilët gjejnë këtu mikpritjen më të pakursyer. Asnjë natë nuk kalon pa mysafirë.”³⁰

Të dhënat kulturore që përshkruhen nga kronikani Evlija Çelebi, janë të vlershme për kohën kur janë shkruar, dhe e kanë vlerën e tyre si kronika. Megjithatë jo gjithmonë janë të sakta dhe të arsyetuara. Meqë autori ka pasur një sens të lartë letrar, siç shihet nga përshkrimet e pasura, nganjëherë ndjehet se kufiri mes të vërtetës dhe imagjinare është i mjegullt. Në disa pjesë i lihet vend fantazisë, pavarësisht se ai thirret në besnikërinë ndaj kronikës, por i ka lejuar vetes të shkojë përtej reales. Në këtë plan, bien

29 *Ibid.*, 65.

30 *Ibid.*, 19.

në sy të dhënat për raportet e meshkujve me meshkuj në shumë prej qyteteve, duke krijuar përshtypjen se dukuria e homoseksualizmit ishte shumë e përhapur dhe natyrshme ndër shqiptarë. Është hera e parë që një udhëpërshkrues i huaj, nga të dhënat dhe vlerësimet që jep për shqiptarët nga shekujt e kaluar, ta shprehë kaq të theksuar praninë e homoseksualizmit apo “qasjen homofilike të shqiptarëve”.³¹ Ajo si e tillë është një fenomen social njerëzor, por këtu krijohet përshtypja se ndër shqiptarë në atë kohë ishte e legalizuar dhe aq më tepër e zakonshme. Çelebiu e përshkruan si formë të argëtimit, të cilën shqiptarët e kanë shprehur hapur dhe lirisht, madje shumë më lirisht se ndjenjat heteroseksuale, marrëdhëniet mashkull – femër. Në libër, dukuria e homoseksualizmit është e pranishme tek pjesa e III-të “Nëpër Shqipërinë Jugore – 1670”, dhe veçanërisht bien në sy pjesët për marrëdhëniet argëtuese mes djemve në qytetet e Gjirokastrës, dhe Elbasanit: “*Qoshku i Lonxhës, jashtë qytetit, ku çdo pasdreke dashnorët mbledhen prapa drurëve të lartë dhe në vendet me hije u vijnë rrotull dylberëve të tyre. Është një vendtakim i këndshëm për njerëzit me kulturë.*”³²

Por, kjo prani e madhe e lëvizjes dhe komunikimit të lejueshëm e të dukshëm mashkullor, e cila Çelebiut i është dukur e pranishme, mund të jetë edhe për faktin se liria e lëvizjes së femrave shqiptare ishte e kufizuar, apo edhe fare e penguar, siç shprehet edhe vetë për gratë gjirokastrite: “Përndryshe, ato nuk dalin kurrë nga shtëpia, qysh nga dita kur lindin deri në ditën e vdekjes, nuk po e marr parasysh zinë dhe vajtimet e së dielës që i përmenda më parë. Ato madje nuk venë as te shtëpia e prindërve, aq të dëlira e të virtytshme janë, tamam si zonja shenjtoze Rabie Adavija”.³³

Seyahatnameja e Çelebiu-t, e cila sipas Robert Elsit por edhe falë punës së tij të përkushtuar të redaktimit ë përkthimit të pjesëve nga kjo vepër, përmban përshkrimet e udhëtimeve të tij janë të mbledhura në dhjetë vëllime në gjuhën turke, ofron një pasuri informacioni mbi historinë kulturore, folklorin dhe gjeografinë e vendeve që ai vizitoi. I shkruar katërqind vjet më parë, sjellë të dhëna interesante dhe të veçanta për aspekte kulturore e sociale të popullsisë dhe vendbanimeve, e konsiderojmë se nëpërmjet risjelljes së këtyre të dhënave, qoftë edhe vetëm në formë rishikimi, edhe në rastet kur të tillat ishin të pasakta, konsiderojmë se kemi arritur t’i shohim sadopak shqiptarë me sytë kulturorë të një tjetri dhe t’ia nxjerrim traditës anët e “fshehura” në histori. Një këndvështrim përshkrues nga tjetri lindor, i shkruar para katër dekadash, kur Ballkani përfshihej tërësisht brenda territorit dhe administrimit ottoman, është me

31 M. NANO, Evliya Çelebi-u dhe “kamera” e tij që sheh nga të gjitha anët, *Res-publica*. 2014, <https://www.respublica.al/arkiv-opinion/evliya-celebi-u-dhe-“kamera”-e-tij-që-sheh-nga-të-gjitha-anët>. (shikuar më: 07.07.2025)

32 R. ELSIE, *Evliya Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje*, 120.

33 *Ibid.*, 63.

inters të shihet, sidomos duke e vënë në krahasim me një këndvështrim tjetër, nga një tjetër kohë dhe nga një kulturë perëndimore, aq më tepër nga një autore grua.

3. Lady Blunt dhe perceptimi i saj për shqiptarët si popuj të Ballkanit

Të dhënat e dëshmitë për shqiptarët nuk na kanë ardhur gjithmonë nga udhëpërshkruesit burra, pasi kemi disa sosh edhe prej autoreve gra³⁴, të cilat mund edhe të mos kenë qenë direkt të ngarkuara me detyra diplomatike, por ndoshta edhe si shoqëruese a bashkëshorte të burrave të tyre. Një fakt tjetër është se edhe në kulturat perëndimore nuk ishin shumë të zakonshme gratë udhëtare, të cilat për shkak të pasionit të tyre për udhëtime në zonat “ekzotike” të Evropës, shumë herë udhëtonin vetëm dhe mbeteshin pa u martuar dhe ky status i tyre nuk ishte fort i pranuar edhe nga mentaliteti perëndimor. Pra, udhëtarët ishin të rralla, por edhe më të rralla ishin botimet e kujtimeve të tyre, të cilat, vetëm pse për autore kishin gratë, nuk përkraheshin.³⁵

Studiuesja Kamberidou, gratë autore të asaj kohe, i ndan në tri kategori: 1. autoret me tituj, siç ishin ato me tituj mbretërorë e fisnikë; 2. autoret misionare, që kishin shërbyer për qëllime humanitare, si vullnetare apo edhe edukatore, dhe 3. autoret nga shtresa e mesme, ku hynin profesionistët, shkrimtarët, artistët, apo thjeshtë kureshtarët që donin të eksploronin botën.³⁶ Në këtë kategori ishte edhe Fanny Janet Sandison Blunt, kjo autore serioze, e cila ka lënë libra të rëndësishëm për trashëgiminë kulturore dhe politike të popujve të Ballkanit.

Autorja Fanny Janet Sandison Blunt (1878), e njohur më shumë si Lady Blunt, tek faqja e Robert Elsie-t për “Dokumente shqiptare” figuron me një tekst (20 faqesh), që është kapitulli për Shqiptarët, i shkëputur nga libri i saj i parë³⁷. Duke e publikuar të papërkthyer nga anglishtja, Robert Elsie, për këtë kapitull në fund shkruan vetëm këtë: “Kapitulli mbi shqiptarët, që përmban shumë prej klisheve standard, jep një pamje interesante të

34 J. FINDER, Finder, *Women Travellers in the Balkans: A Bibliographical Guide*, në: J. B. Allcock – A. Young (eds.), *Black Lambs and Grey Falcons – Women Travellers in the Balkans*, Bradford University Press, UK, 1991, 192-201.

35 I. KAMBERIDOU, *The East in the Eyes of Western Women travellers of the 18th and 19th centuries: solidarity and understanding the East*, në: *The East in The Eyes of The West*, In proceedings of the International Conference ‘The East in the Eyes of the West’, Nov. 26-28, 2013. Proceedings published May 2015, Kuwait University Faculty of Arts 285 – 311.

36 *Ivi*.

37 F. J. S. BLUNT, *The People of Turkey: Twenty Years’ Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks and Armenians I, II*, John Murray, London, 1878.

njohurive të shekullit XIX për shqiptarët dhe pikëpamjet për ta”³⁸ Kaq! Por të shohim më tutje kush është kjo autore dhe çka në të vërtetë ajo shkruan për shqiptarët?

3.1. Kush ishte Fanny Janet Sandison Blunt (1839 – 1926)?

Autorja, Fanny Janet Sandison, e njohur më vonë si Lady Blunt, është e lindur në rrethinat e Stambollit. Ishte e bija e Donald Sandison-it, tregtarit britanik i cili kishte shkuar në Turqi fillimisht si përfaqësues i Kompanisë britanike të Indisë Lindore, e më pas Kompanisë britanike levantine. Pas kryengritjes së jeniçerëve (1826), me ç’rast ai kishte humbur shumë nga biznesi dhe patundshmëritë e tij në Turqi, mbretëresha britanike Viktoria e kishte emëruar konsull të Britanisë së Madhe në Bursa, ku ishte shpërngulur ai me familjen e tij për të jetuar.³⁹ Janet Sandison, që ishte më e vogla e familjes, pas katër motrave dhe vëllait, kishte lindur në Therapia, atëherë rrethinë e Kostandinopojës, përsikaj brigjeve të Bosforit, siç shkruan ajo vetë në librin “My Reminiscences”⁴⁰.

Ishte rritur në shkollat amerikane, ku mësonin fëmijët e diplomatëve perëndimorë në Bursa, atëherë qendër me rëndësi të madhe ekonomike (sidomos për tregtinë e mëndafshit) ku ishin tubuar shumë tregtarë britanikë e amerikanë. Më pas ishte martuar me Sir John Elijah Blunt, i cili u emërua zëvendëskonsull britanik në Shkup dhe Shqipëri⁴¹. Duke qenë e bija e konsullit dhe më pas bashkëshortja e zëvendëskonsullit britanik, ajo pati rastin të përfaqësojë elitën diplomatike evropiane dhe të ketë informacion politik nga dora e parë. Interesimi i saj për të njohur popujt nën Turqinë, për të njohur tiparet e tyre etnike dhe për të shkruar për to, flet jo vetëm për një formim të qëndrueshëm kulturor të saj, por edhe për një vetëdije trashëgimore. Për më shumë, shkrimet e tilla nga një grua, ishin shumë të rralla për kohën kur u shkruan.

Në Arkivin virtual të Kalifornisë gjenden dy libra të saj, ku ndonëse i pari nuk është tërësisht i panjohur për studiuesit shqiptarë,⁴² për të dytin nuk e kam hasur ndonjë informacion më pare. I pari është dyvëllimësh, me titullin “The People of Turkey: Twenty Years’ Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks and Armenians” [në shqip: Popujt e Turqisë – njëzet vjet jetesë midis bullgarëve, grekëve, shqiptarëve, turqve dhe armenëve], i

38 R. ELSIE, Fanny Janet Blunt, *The Albanians*, <http://www.albanianhistory.net/1878-Blunt/index.html> (shikuar më: 10/12/2025).

39 E. ZEYTINLI, *A British Merchant in Turkey: Freeman of the Levant Company and Consul, Donald Sandison at Bursa, 1795–1868*, “Turk J Hist”, issue 68 /2018, 31-56.

40 F. J. S. BLUNT, *My Reminiscences*, John Murray, London, 1918.

41 *Ibid.*, 54.

42 D.H. Statovci, *Reflektime etnokulturore në Deçan me rrethinë (1990-1999)*, “Gjurmime albanologjike, seria folklor dhe etnologji”, 46/2016, IAP, Prishtinë, 171-183 /175..

botuar më 1878 në Londër. Libri i saj i dytë me titull “My Reminiscences” [shqip: Kujtimet e mia], është i botuar gjithashtu në Londër, më 1918. Këta dy libra i kam gjetur duke gjurmuar një tjetër burim në Arkivin virtual të Kalifornisë dhe i vlerësoj si referenca me shumë vlerë për shqiptarët, kulturën, traditën e rrethanat politike të kohës që i referohen.

Duke e përfaqësuar shtetin që ishte pjesë e Fuqive të Mëdha, njohuritë politike të Lady Blunt vijnë drejtpërdrejt nga sferat e interesit të këtyre fuqive, prandaj paraqitja e këndvështrimeve specifike nënkupton edhe qëndrimet e këtyre fuqive ndaj popujve të nënshtuar nga Perandoria Osmane. Këtu duhet të kemi parasysh edhe faktin që e përmendin Wolff dhe Todorova, se udhëtarët evropianë interesim për Ballkanin si tërësi gjeografike e kulturore shfaqën vetëm aty nga fundshekulli XVII, atëherë kur nis e shfaqet vetëdija se zotërimet e Perandorisë Osmane në Evropë kishin një fizionomi të veten të dallueshme që meritonte vëmendje të veçantë, ndaras nga trajtimi i thjeshtë si provincë e osmanëve apo si zonë arkeologjike.⁴³ Është e çuditshme se pse, as Todorova dhe as Jezernik-u, nuk u referohen librave të Lady Blunt-it, sidomos librit të saj të parë dyvëllimësh, i cili është shumë reprezentativ për fokusin e tyre të studimeve. Qëndrimet e autores për shqiptarët sot mund të konsiderohen të pasakta, të tejkaluara, ndoshta edhe tendencioze, por nuk mund ta mohojmë faktin se ajo kishte njohuri për karakterin e shqiptarëve, si edhe për marrëdhëniet e tyre me sundimtarët e ardhur. Informacionet e këtilla që vijnë nga para dyqind vjetësh, hedhin dritë për kulturën, kombin dhe historinë e shqiptarëve në atë kohë.

3.2. Mbi karakterin dhe normat e shoqërisë tradicionale shqiptare

Libri i parë, dyvëllimësh, “*Popujt e Turqisë – njëzet vjet jetesë midis bullgarëve, grekëve, shqiptarëve, turqve dhe armenëve*” është një histori sociale për jetesën dhe veçoritë etnike të këtyre popujve në Parandorinë osmane, krahas edhe hebrenjve, kaukazianëve, tatarëve dhe romëve, të cilët zënë më pak hapësirë. Ky libër, i cili në disa botime del me autor të shoqin, zëvendëskonsullin britanik, Sir John Elijah Blunt, e në disa tjera e ka autore gruan e tij, ka shumë gjasë që të ketë qenë në bashkautorësi të të dyve. Të dhënat me shumë vlerë për shqiptarët, për sjelljet e shqiptarëve në raport me fqinjët, por edhe me pushtuesit otomanë, të cilat dalin në këtë libër janë të dhëna të cilat i shohim nga një perspektiva e një përfaqësueseje diplomatike të Fuqive të mëdha, nga perspektiva e një bashkëjetueseje me përvojë 20-vjeçare me pjesëtarë të këtyre popujve.

Librat ndahen në katër pjesë. Në pjesën e parë flitet për karakteristikat e përgjithshme të këtyre popujve, pa u ndalur në histori, por më tepër për

43 M. TODOROVA, *Ballkani imagjinar*, f. 98.

gjendjen e tyre në atë kohë, e sidomos për rrethanat sociale dhe tiparet kombëtare. Në pjesën e dytë flitet për zotërimin e tokës, gjendjen e fermerëve dhe strukturën organizative të rregullimin shtetëror të Turqisë në raport me popujt e dominuar: bullgarët, grekët, shqiptarët, turqit dhe armenët, krahas përshkrimeve më të pakta për hebrenjtë, kaukazanët, tatarët dhe romët.

Pjesa e tretë u kushtohet traditave dhe tipareve të veçanta nacionale të këtyre popujve, sidomos traditave rreth ciklit të jetës (lindjes, martesës e vdekjes), krahas tipareve të tjera etnokulturore dhe larushisë së veshjeve kombëtare, duke i ilustruar me episode nga jeta praktike. Këto episode të detajuara, si pasojë e përvojave personale të autores gjatë kontaktit me pjesëtarë të këtyre popujve, sjellin të dhëna të çmueshme për traditat. Për shembull, sipas recensentit Stanley Lane Poole, i cili i vlerëson të dhënat që sjell Lady Blunt në libër, si e dhënë kualitative jo kuantitative, ndër të tjera, paraqet interes të veçantë zakoni i dhëndrit shqiptar, përmes të cilit, dhëndri, duke e hedhur një pengesë mbi qafën e nuses dhe duke e tërhequr atë në shtëpinë e tij, shpreh një relike interesante të grabitjes së nuses. Më pas, trokitja e saj në mur me kokë, si një paralajmërim kundër pabesisë, e ilustron dëshirën e njerëzve për dëlirësinë e përgjithshme.⁴⁴

Pjesa e katërt ka të bëjë me arsimimin, besimet dhe bestytnitë, raportet e tyre me institucionet dhe krerët fetarë. Ky libër është vlerësuar për rëndësinë kulturore nga kritika amerikane dhe sot është pjesë e kategorisë së librave mbi civilizimet botërore. I konsideruar si një libër me vlerë, tek kategoria e librave të harruar, ribotimin e fundit ky libër e pati më 14 maj 2018 nga shtëpia botuese “Forgotten books” në Londër, e cila merret me ribotimin e librave klasikë.

Në vëllimin e parë të titulluar “The Races of Turkey” [shqip: “Racat e Turqisë”], krahas bullgarëve dhe grekëve të Turqisë, të tretët renditen shqiptarët. I tërë kapitulli i tretë, që përmban afër tridhjetë faqe, është një pasqyrë e përgjithshme për shqiptarët. Shqipëria cilësohet si vend pak i njohur nga udhëtarët e huaj, si vend i izoluar dhe i neglizhuar. Hapësira e saj gjeografike përshkruhet kështu:

“Ky vend, që zë vendin e Ilirisë antike dhe Epirit, në mesjetë është quajtur Arvanasi dhe më vonë Arnautllëk nga turqit e Arvanitia nga grekët, por në gjuhën e vendasve është quajtur Skipëri, ose “tokë shkëmbore”. Është e ndarë në Shqipërinë e Epërme dhe në atë të Poshtme, që i formojnë dy vilajete – Vilajetin e Shkodrës (...) dhe atë të Janinës (...).⁴⁵

44 S. L. POOLE 1878, Preface, *The People of Turkey: Twenty Years' Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks and Armenians I*, John Murray, London, 1878, X.

45 F. J. S. BLUNT, *The People of Turkey*, 63.

Me një toponimi precize, me emrat e qyteteve shumë afër atyre që i njohim edhe sot (përveç ndonjë varianti si *El Bassan* apo *Tessi*, nëse është fjala për Lezhën?!), krahas edhe ndarjes së vilajeteve, është informacion i rëndësishëm historik e gjeografik, por gjithashtu paraprijës për përcaktimin e tipareve racore e regjionale të shqiptarëve, të cilat autorja i dallon dhe identifikon me mjaft detaje, si më poshtë:

“Gegëria, shtrihet nga kufijtë e Bosnjës dhe Malit të Zi deri në Berat. Në trimëri, besueshmëri dhe nder, gegët e mbajnë primatin. Gega nuk niset “të marrë rrugë”, në qoftë se ai ka pak para dhe nuk ka asgjë më të mirë për të bërë. Në qoftë se dikush që mund ta takojë rrugës e shpërfill urdhrin e tij për t’u ndalur, ai mendon që t’ia presë fytyrën, apo të bëjë zgjidhje me një të shtënë pistolette; por në qoftë se një gegë e ka shijuar një herë bukën dhe kripën tuaj ai ju bëhet borxhli, ai do t’ju jetë mirënjohës dhe do të jetë në shërbimin tuaj. Të gjitha cilësitë e tij të tmerrshme do të zhduken, ai do të bëhet më i devotshëm dhe më besniku nga të gjithë miqtë dhe shërbëtorët. Në përgjithësi, gegët janë të kursyer dhe jo shumë të varur nga zakonet aziatike. Gratë janë të respektuara prej tyre dhe rrallë të ekspozuara ndaj sulmeve të banditëve ose libertinëve. Këto karakteristika janë aq të përgjithshme dhe aq thellë të rrënjësura në karakterin e gegëve, saqë konsujt, tregtarët dhe të tjerët, të cilët kanë nevojë për mbështetës të guximshëm dhe besnikë, preferojnë t’i punësojnë ata para njerëzve të çdo race tjetër”.⁴⁶

“Toskët, që banojnë në Shqipërinë e poshtme, në sanxhakun e Vlorës dhe të Beratit, si dhe çamët dhe labët e sanxhakut të Delvinës dhe Janinës, e quajnë vendin e tyre Çamëri dhe Labëri. Këta të fundit supozohet se janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të helenëve të lashtë, sepse ata flasin gjuhën greke me pastërti më të madhe se pjesa tjetër; sigurisht disa nga tiparet e tyre karakteristike janë të ngjashme me ato të grekëve të lashtë. Të gjithë shqiptarët e Epirit e përdorin gjuhën greke më mirë se turqishten, e cila në disa vende nuk flitet fare. Toskët janë të gjatë dhe të ndërtuar mirë, shumë të shkathët në të gjitha lëvizjet e tyre; karakteristikat e tyre janë të rregullta dhe inteligjente, por si shumica e shqiptarëve kanë një çast të ashpër, mizor dhe nganjëherë dinak të fytyrës, si dhe një krekosje në ecje të tyre, me të cilën ata lehtë mund të dallohen nga racat e tjera, madje edhe kur janë të zhveshur nga kostumet e tyre kombëtare”.⁴⁷

46 *Ibid.*, 71.

47 Ivi.

Cilësimet e sipërpërmendura dhe të veneruara, mund edhe të jenë stereotipe për shqiptarët siç i shihnin të huajt, por ato shumë herë janë të shoqëruara me detaje dhe të dhëna të cilat Lady Blunt ose i ka përjetuar vetë, ose i ka dëgjuar nga përvojat e diplomatëve. Madje në libër nuk mungojnë edhe përshkrimet e situatave, të cilat kanë ndikuar në krijimin e gjykimeve të saj. Një rast i tillë ishte kur zonja Blunt, e shoqëruar nga një funksionar i pasur i krishterë dhe nga eskorta e saj, duke kaluar nëpër një grykë malore në Shqipëri, ndeshet me një grup banditësh. Përkundër paragjykitimit dhe frikës nga një përvojë e keqe me ta, zonja angleze mbetet e befasuar me mirësjelljen dhe kurtuazinë që ata treguan ndaj shoqëruesve të saj, e në veçanti ndaj vetë asaj, zonjës. Rrëfimin e mbyll me këtë paragraf:

“Pasi kishim kaluar një copë rrugë, miku im që ndihej i lehtësuar më tha: A e dini që ai që drekoi me ne, ai që ju qëndroi në këmbë duke ju përshëndetur dhe që ju ndihmoi derisa ju i hipët kalit, është prijësi më i ashpër i banditëve të kësaj zone! Për shtatë vjet ai dhe banda e tij e kanë terrorizuar zonën duke plaçkitur e vrarë shumë njerëz, duke mos respektuar askënd, përveç atyre të gjinisë suaj – dhe vazhdoi - unë këtu bëhem bestyt, ose le të themi ishte një moment nderi, pasi shqiptarët kanë qëndrim shumë rigoroz, se për ta është burracakëri të sulmohesh grate”.⁴⁸

E intriguar nga sjellja e shqiptarëve me gratë, nga statusi i këtyre të fundit, por edhe nga pozita e tyre komplekse në mjedisin patriarkal shqiptar, autorja Blunt, në librin e saj, grave iu referohet shumë herë. Përderisa në njërën anë ato mbesim të izoluara brenda mureve të shtëpisë, duke mos iu dhënë e drejta e arsimimit dhe e emancipimit, në anën tjetër siguria absolute që të ofrohet duke qenë i shoqëruar nga një grua, në një shoqëri ku hakmarrja dhe besa mbesin kodet kryesore mbi të cilat funksiononte ajo shoqëri, e bëjnë vërtetë interesant dhe unik rolin e gruas shqiptare. Gjithashtu, të dhënat që vijnë nga këndvështrimi i një gruaje në atë kohë janë veçanërisht me interes dhe do të duhej të vlerësoheshin për saktësinë. Fakti se depërtimi tek informacionet për gratë myslimane në Ballkan ishte i pamundur, tregon se të dhënat e ardhura nga autorët burra ishin burime të dorës së dytë e të tretë, prandaj vërtetësia e këtyre të dhënave për gratë ballkanase, që vijnë nga një grua, është për t'u vlerësuar.

“Gratë shqiptare në përgjithësi janë të armatosura, jo për qëllime të vetëmbrojtjes – asnjë shqiptar nuk do ta sulmojë një grua në vendin e tij, por që ato të jenë në gjendje të bashkohen në grindjet e të afërmeve të tyre meshkuj, për të luftuar në anën e tyre. Nderimi i ofruar me përgjegjësinë e grave është një zakon i çuditshëm midis

48 *Ibid.*, 71-73.

shqiptarëve - të huajve që dëshirojnë të kalojnë nëpër vendin e tyre, ata ua ofrojnë gratë për t'i shoqëruar. Kështu, udhëtari i shoqëruar nga një grua mund të vazhdojë të udhëtojë i sigurt në rajonet më të izoluar, pa frikën e lëndimit nga dikush.”⁴⁹

Të cilësuar si një shoqëri që funksionon sipas kodeve e normave mbi nderin, besën, gjakmarrjen, pronën, ligjësi shoqërore këto të normativizuara dhe të zbatuara rreptësisht brenda saj, pavarësisht sjelljeve të vrazhda e egërsisë në karakter, për Blunt-in shqiptarët mbeshin besnikë në brendësinë e karakterit të tyre, siç edhe shprehet në fund:

“Shqiptari, gjithashtu, mund të plaçkisë, por ai e bën atë hapur dhe me armë në dorë në rrugë të madhe; jo pas shpine ose në “këmbim” (...) Ai më shpesh ka abuzuar sesa vlerësuar, por kjo ndodh më së shumti për shkak të mungesës së dijes; gabimet e tij janë në sipërfaqe, ndërsa cilësitë e tij të mira e të pastra janë vetëm për ata që e njohin mirë shqiptarin dhe dinë se si ta trajtojnë atë.”⁵⁰

3.2. Nga kujtimet e fëmijërisë deri tek bashkëjetesa me shqiptarët: Shqipëria e epërme, Shkupi

Libri i dytë “My Reminiscences” [Kujtimet e mia], i cili u botua dyzet vjet pas botimit të librit të parë, është i tipit autobiografik dhe e përplotëson të parin. Është më tepër shkrim subjektiv dhe jo fort i zakonshëm për vitet kur u shkrua. Përshkrimi deri në detaje i jetës në Bursa, i fëmijërisë jo të lehtë në shtëpinë ku i vdes e motra nga kolera, të burgosurit politikë të strehuar në Bursa, boshnjakët, rumunët e strehuar, lufta e Krimesë, tërmeti me shumë dëme në Bursa dhe zhvendosja në Kostandinopojë (Stamboll), udhëtimi në Bitol (Manastir), takimi me heroinat serbe e kurde, takimi me zëvendëskonsullin e ri të Britanisë, e deri te fejesa e martesja me të, bën që ngjarjet madhore historike të përjetohen realisht, t’i bashkëndiejmë ashtu siç i ka ndjerë vetë autorja.

Misionet diplomatike përkrah të shoqit në Shkup, kontakti me shqiptarët, roli i kishave greke e bullgare, udhëtimet në Beograd, Vjenë, Adrianopojë, Nish, Selanik, rebelimi i pashait arab, apo vrasja e një konsulli, e ngjarje si këto, pavarësisht se kanë ngjarje politike i bashkëlidh me situata personale si lindja e të birit apo sëmundja e të shoqit, i japin karakter romanor këtyre faqeve dhe duken shumë të prekshme dhe praktike. Përshkrimi i situatave të përditshme me një lehtësi dhe aftësi kaq të madhe narrative, kur ngjarjet e figurat historike që përfshijnë takime diplomatësh e misione, edhe sekrete, në vende e territore mbarëballkanike, që hyjnë e dalin nga rrëfimi

49 *Ibid.*, 83.

50 *Ibid.*, 86.

i jetës së Blunt-it, të japin përshtypjen sikur janë aty për t'i ndihmuar narratores në rrëfim.

Krahas detajeve nga jeta e saj dhe e familjes në Bursa, si dhe bashkëjetesa me popujt e tjerë në përditshmërinë e saj në Turqi, Blunt sjell fakte shumë interesante edhe për shqiptarët, fati i të cilëve ishte i ndërlidhur me Turqinë e asaj kohe. Për shembull, në librin e “Kujtimeve” shkruan se nga rinia e saj e kujton se, në Bursa vinin shumë refugjatë politikë, kryesisht evropianë. Ndër të parët kishin qenë pasardhësit e familjes së Ali Pashë Tepelenës. Kishte dëgjuar se ai kishte qenë shumë i pasur dhe tërë pasurinë e kishte të fshehur nën shtratin e lumit që buronte nga Janina. Djali i tij, nga dëshpërimi i rënies së familjes, kishte pirë shumë arsenik, por e kishin shpëtuar duke i dhënë të pijë të bardhën e tetëdhjetë vezëve!⁵¹ Ndërlidhja e të dhënave historike e politike nga terreni me ndjeshmërinë artistike të botës së saj femërore, i japin shumë emocion dhe vlerë artistike faqeve të këtyre librave. Detajet etnokulturore i japin peshë të veçantë përshkrimeve të saj, sidomos kur ato shihen nga një perspektivë pas afro dyqind vjetëve. Duke u ndjerë e ambientuar me kulturën dhe mentalitetin shqiptar sa ishte e pamartuar, ajo në një rast, gjatë analizimit të korrespondencës me burrin e saj të ardhshëm, nisur nga një situatë krejt personale, për shqiptarët do të shkruajë:

“Duke e shikuar korrespondencën me Sir John në Uskub⁵², pothuajse në çdo letër që unë e marr e gjej emërtimin “egërsi shqiptarë”; e megjithatë është e çuditshme të thuhet kështu për një popull fisnor, shqiptarëtgegë, të cilët kanë ligje të rrepta të pashkruara për rregullimin e jetës së tyre shtëpiake, në lidhje me respektin për vlerat e nderit, ndershmërinë dhe moralin, të cilat zbatohen shumë rreptë prej tyre, shumë më tepër se sa tek popujt e civilizuar dhe ligjvënës.”⁵³

Lady Blunt e kishte filluar jetën bashkëshortore në Uskub, siç shkruan për Shkupin, ku me të shoqin, zëvendëskonsullin britanik për Shqipërinë dhe Shkupin, kishin jetuar gjatë viteve 1858 – 1902, prej nga më pas ishin larguar për të jetuar në Maltë, ku edhe ajo vdiq më 1926. Një detaj kulturor për takimin e parë të saj me Shkupin e atyre ditëve do ta parafranoj këtu: Të nesërmen e ardhjes së saj në Shkup, të cilin e pëlqeu si qytet i ndritshëm dhe i dashur, Lady Blunt kishte dalë me të shoqin krah për krah për të shëtitur nëpër qytet. Ishte fundi i shekullit të XIX dhe një pamje e tillë ishte e pazakonshme për qytetin... Shpejt fjala kishte marrë dhenë se ‘Konsull beu britanik ishte i sëmurë sepse gjatë shëtitjes ishte mbajtur për krahun

51 BLUNT, *My Reminiscences*, 23.

52 Shënim: Emri i Shkupit në turqisht.

53 Blunt, *My Reminiscences*, 70.

e hanëmes së tij!⁵⁴ Përveç si mendësi ballkanase, nëpërmjet përshkrimeve të saj për Shkupin e asaj kohe, mundësohet të kuptojmë edhe për fushën etnografike e religjioze të Ballkanit në përgjithësi. Shkupi dhe Maqedonia si regjion gjeografik, në atë kohë, përbëhej nga një përzierje gjuhësh, religjionesh e komunitetesh, të cilën autorja Sandison Blunt e quante - *një sallatë maqedonase*.⁵⁵ Madje, nisur nga ky libër i saj dhe nga të dhëna të tjera për jetesën dhe shkollimin e fëmijëve të diplomatëve perëndimorë në Turqinë otomane, studiuesi grek Andrea Bouroutis i bën një analizë të detajuar gjendjes së arsimit, të shkollave e të klubeve shoqërore që funksiononin në Selanikun e shekullit XIX, ku shërbeu si konsull britanik, bashkëshorti i zonjës Blunt, në periudhën 1873 – 1899.⁵⁶

Gjithashtu një episod tjetër: frikës së saj se do t'i duhej që ta shoqëronte të shoqin në Shqipëri, në një moment konsulli i ishte përgjigjur: “E dashur, a mendon se unë jam i tillë sa të të mbaj ty në atë vend të egër si Shqipëria? Çdo karrierë e ka një fillim dhe më vjen keq që unë duhet ta filloj atje, por të premtoj se do të jetë vetëm për një kohë të shkurtër, për çka e kam informuar edhe qeverinë në Londër.” Mirëpo çifti Blunt nuk do të largohej shpejt nga shqiptarët, për shkak të obligimeve diplomatike të zëvendëskonsullit. Ata do të vazhdojnë të jetojnë gjatë ndërmjet Shkupit e Shqipërisë Veriore dhe asaj Jugore, për banorët e së cilës Lady Blunt do të shkruajë jo pak në librat e saj. Qëndrimi i saj, më shumë se moral e gjykues, është një këndvështrim etnografik, sociologjik e historik për kulturën e Lindjes, për përditshmërinë, për marrëdhëniet racore e gjinore, si dhe për raportet me institucionet në fuqi.

Përfundim

Në veprën “Seyahatname” të Evliya Çelebiut dhe librat e Fanny Janet Sandison Blunt, shqiptarët përshkruhen nga dy këndvështrime të ndryshme kohore dhe kulturore, por me disa ngjashmëri të dukshme. Të dy autorët i përshkruajnë shqiptarët si njerëz trima, mikpritës dhe me ndjenja të theksuara nderi. Evliya Çelebiu, udhëtar osman i shekullit XVII, thekson karakterin luftarak dhe besnikërinë ndaj zakoneve të tyre, ndërsa nuk kursen vërejtje për ndonjë ashpërsi apo mungesë civilizimi sipas standardeve osmane. Nga ana tjetër, Fanny Blunt, një udhëtare britanike e shekullit XIX, ofron një perspektivë më romantike dhe etnografike; ajo

54 *Ibid.*, 65.

55 *Ibid.*, 133.

56 A. K. BOUROUTIS, Schools, Clubs, and Enterprise: Clusters of Social and Religious Coexistence in Ottoman Salonica, *Journal of Religion & Society*, 19, Creighton University, Nebraska, 19., 68 – 82.

<https://dspace2.creighton.edu/xmlui/handle/10504/64277/browse?value=Bouroutis%40C+Andreas+K.&type=author> (shikuar më: 09.01.2020).

i vlerëson shqiptarët për natyrën e tyre të egër, por të ndershme, dhe për bukurinë natyrore të vendit të tyre. Ngjashmëria kryesore qëndron në admirimin për guximin dhe mikpritjen shqiptare. Dallimi kryesor vjen nga sfondi kulturor i tyre dhe këndvështrimi subjektiv, krahas pozicionit administrativ kundrejt shqiptarëve që kishin kulturat respektive që ata përfaqësonin: Çelebiu shkruan si pjesë e një perandorie që sundonte shqiptarët, ndërsa Blunt si e huaj që vështron me kuriozitet dhe simpati. Perceptimet e tyre, ndonëse të ndryshme, pasqyrojnë një popull me identitet të fortë dhe të dallueshëm. A mund të themi se me gjithë dallimet hapësinore dhe kulturore: Lindje dhe Perëndim dhe dallimet kohore: shek. XVII dhe shek. XIX, të dy autorët i panë shqiptarët si ekzotikë dhe të veçantë nga të tjerët popuj të Ballkanit, ndonëse në mënyra të ndryshme dhe me qëllime të ndryshme? Po, gjithsesi.

Evlija Çelebiu, si udhëtar osman, i përshkruan shqiptarët si ndryshe nga popujt e tjerë të Perandorisë Osmane: të egër, trima, besnikë ndaj zakoneve të tyre dhe shpesh të pabindur ndaj autoritetit qendror. Për të, shqiptarët ishin pjesë e një bote periferike, me zakone të veçanta, gjuhë të ndryshme dhe një jetë malësore që dallohej nga normat urbane osmane. Ky “ekzotizim” nuk ishte vetëm etnik, por edhe kulturor e shoqëror. Ai si përfaqësues i Perandorisë Osmane, e sheh Shqipërinë dhe shqiptarët kryesisht në dritën e sundimit dhe stabilitetit politik që ajo kërkonte të ruante. Ai percepton shqiptarët si një komunitet me një natyrë të fortë dhe shpirt luftarak, por edhe të pakontrolluar dhe ndonjëherë sfidues ndaj autoritetit, që në sy të tij përbën një sfidë për rendin osman. Në këtë kuadër, përshkrimet e tij shpesh kanë një nuancë administrative dhe madje edhe kritike, duke reflektuar nevojën për kontroll dhe integrim të këtij elementi periferik në perandorinë e madhe.

Fanny Blunt, nga këndvështrimi britanik i përshkruan shqiptarët me një ton më romantik dhe folklorik, si “fisnikë të egër”, të pakorruptuar nga moderniteti, me një lidhje të ngushtë me natyrën dhe nderin. Shqiptarët për të janë ekzotikë sepse janë të ndryshëm nga evropianët e qytetëruar, por kjo “egërsi” përçmohet më pak dhe më shumë idealizohet. Ajo me sensin e saj të theksuar etnografik dhe interesin për kulturat “e tjera”, i sheh shqiptarët në mënyrë më idealizuese dhe romantike, si një popull që ka ruajtur një pastërti të veçantë shpirtërore dhe kulturore në mes të ndryshimeve të kohës. Për Blunt, shqiptarët janë një lloj simboli natyror i paprekur dhe një mënyre jetese që përçon një ndjenjë nderi dhe fisnikërie, ndonëse kjo “egërsi” dhe largësi nga qytetërimi modern shihet si një tipar që i bën tërheqës dhe unikë.

Kështu, përtej dallimeve, të dy vëzhguesit ndajnë një admirim të thellë për karakterin shqiptar, duke e dalluar atë nga popujt e tjerë të rajonit. Ky vlerësim i përbashkët tregon se, pavarësisht dallimeve në periudhë dhe

prejardhje kulturore, shqiptarët kanë ruajtur një identitet të fortë dhe të dallueshëm, që ka lënë gjurmë të qarta në kujtesën historike dhe letrare të vizitorëve të huaj.

Në përfundim, mund të themi se Evliya Çelebiu dhe Fanny Blunt, pavarësisht dallimeve në pikëpamje, frymë dhe qëllime, përbëjnë dëshmi të rëndësishme të një populli që ka sfiduar kohën dhe kulturat e ndryshme për të ruajtur karakterin dhe dinjitetin e tij. Ky dyshim i tyre për shqiptarët si një komunitet “ekzotik” dhe unik, të cilin e perceptojnë në mënyra të ndryshme, nënvizon rëndësinë e studimit dhe mirëkuptimit të kulturave përmes lenteve të ndryshme historike dhe kulturore. Ky dialog mes dy periudhave dhe dy botëkuptimeve pasqyron kompleksitetin e identitetit shqiptar dhe përballjen e tij me botën përreth, duke na bërë të kuptojmë më mirë jo vetëm shqiptarët, por edhe natyrën dinamike të perceptimeve kulturore në përgjithësi.

LITERATURA

- Allcock, John B, Antonia Young (eds.), *Black Lambs and Grey Falcons – Women Travellers in the Balkans*, 1991, Bradford University Press, UK.
- Blunt, Fanny Janet Sandison, *The People of Turkey: Twenty Years' Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks and Armenians I, II*, 1878, John Murray, London.
- Blunt, Fanny Janet Sandison., *My Reminiscences*, 1918, John Murray, London.].
- Bouroutis, Andreas K., *Schools, Clubs, and Enterprise: Clusters of Social and Religious Coexistence in Ottoman Salonica*, “Journal of Religion & Society”, 19/2019, Creighton University, Nebraska, 67-82. <https://dspace2.creighton.edu/xmlui/handle/10504/64277/browse?value=Bouroutis%0AC+Andreas+K.&type=author> (shikuar më: 09.09.2024).
- Dankoff, Robert and Sooyong Kim (eds.), *An Ottoman Traveler*, 2011, Eland, London.
- Dankoff, Robert, *An Ottoman Mentality-The World of Evliya Çelebi*, 2006, Brill, Leiden – Boston.
- Dankoff, Robert, and Robert Elsie, *Evliya Çelebi in Albania and Adjacent Regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*, 2000, Brill, Leiden.
- Di Lellio, Anna, *The Battle of Kosovo 1389: An Albanian Epic*, 2009, I.B. Tauris, London.
- Doja, Albert, *Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri*, 2018, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- Dushi, Arbnora, *Shqiptarët në veprat dhe kujtimet e Lady Blunt*, 2009,

- “Gjurmime Albanologjike” seria folklor dhe etnologji 49/2009. Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Dushi, Arbnora, *Të dhëna për folklorin shqiptar në udhëpërshkrimet e Evlija Çelebiut*, 2015, “Albanologji” “II-14/2015, Instituti Albanologjik, Prishtinë,
- Elsie, Robert, *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mali Zi, Ohër*, Abdurrahim Myftiu (përkth.), 2008, Shtëpia Botuese 55, Tiranë.
- Elsie, Robert, Fanny Janet Blunt, *The Albanians*, http://www.albanianhistory.net/1878_Blunt/index.html (shikuar më: 10/03/2025).
- Elsie, Robert. *Texts and Documents of Albanian History*, <http://www.albanianhistory.net/> (shikuar më: 12/03/2025).
- Hagen, Gottfried, *Ottoman Understandings of the World in the Seventeenth Century*, “An Ottoman Mentality-The World of Evliya Çelebi”, 2006, Brill, Leiden, Boston.
- Halimi-Statovci, Drita. *Reflektime etnokulturore në Deçan me rrethinë (1990-1999)*, “Gjurmime albanologjike”, seria folklor dhe etnologji, 46/2016, IAP, Prishtinë.
- Jezernik, Bozidar, *Evropa e egër*, (përkth. D.Varfi), 2010, Plejad, Tiranë.
- Kamberidou, Irene, *The East in the Eyes of Western Women travellers of the 18th and 19th centuries: solidarity and understanding the East*, “The East in The Eyes of The West” 2015, Kuwait University Press]. DOI: [10.13140/2.1.3405.1365](https://doi.org/10.13140/2.1.3405.1365)
- Nano, Mustafa, Evliya Çelebi-u dhe “kamera” e tij që sheh nga të gjitha anët, Res-Publica, 2014, <https://www.respublica.al/arkiv-opinion/evliya-celebi-u-dhe-“kamera”-e-tij-që-sheh-nga-të-gjitha-anët> (shikuar më:07.07.2025)
- Poole, Stanley Lane, Preface, *The People of Turkey: Twenty Years’ Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks and Armenians* I, 1878, John Murray, London.
- Said, Eduard, *Orientalizmi: Imagjinimi evropian i Orientit*, (përkth. N. Seitaj), 2009, 2 Lindje dhe 2 Perëndime, Tiranë.
- Todorova, Maria, *Ballkani imagjinar*, (përkth. B. Shehu), 2006, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë.
- Wolff, Larry, *Inventing Eastern Europe: The Map of Civilization on the map of the Enlightenment*, 1994, Stanford University Press, California.
- Zeqo, Miokom, Teori falsifikimi për origjinën e shqiptarëve, Gazeta Dielli, <https://gazetadielli.com/teori-falsifikimi-per-origjinen-e-shqiptareve/> [shikuar më: 13/VI/2025].
- Zeytinli, Emine, *A British Merchant in Turkey: Freeman of the Levant Company and Consul, Donald Sandison at Bursa, 1795–1868*, “Turk J Hist”, issue 68 /2018, 31-56.

